


REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ORTAKU I VETËMI SHOQËRISË
"MILO - 2000" SH.P.K. PERMET



V E N D I M

Nr. 2 Datë 21/07/2005

Sot me datën 21/07/2005 ,ne seline e shoqerise " MILO - 2000" Shpk Permet ,
Ortaku i vetëm i kesaj shoqerie Olsi MILO,mori në shqyrtim kete rend dite:

- a- Miratimin e raportit te Ekspertit per Kontributet Bashkim Gjata te dates 21.07.2005 , lidhur me zmadhimin e kapitalit themeltar te shoqerise nepermjet kontributit ne natyre.
- b- Zmadhim i kapitalit themeltar me derdhje në para , kjo me anë të fitimeve të rezultuara nga ushtrimi financiar i mbyllur për vitin 2004,
- c- Ndryshime në Statutin e shoqërisë, për të cilat mbasi u diskutua,

V E N D O S A:

1. Në mbështetje të neneve 42 dhe 63 të Ligjit si më sipër , të miratoi Raportin e Ekspertit Kontabël të Autorizuar z.Bashkim Gjata i caktuar nga ana i me me Vendimin Nr. 1 datë 30/06/2005 , i depozituar në Gjykatën e shkallës së parë Tiranë Nr. 24443/1 - datë 20/07/2000 në cilësinë e Ekspertit të Kontributeve , sipas të cilit vlera e kontributit në natyrë të shoqërisë është **10.598.333** lekë e ndarë sipas zërave makineri paisje e instalime , mjete transporti vlerë kjo e cila të kalojë per zmadhimin e kapitalit themeltar te nenshkruar të shoqërisë.
2. 2- Me fitimet neto te ushtrimit të vitit 2004 në shumën **1.080.000** lekë si dhe fitimet neto të mbartura nga vitet e kaluara në shumën **2.145.864** lekë , gjithsejt në shumën **3. 225.864** lekë, per të cilat per efekt garancie sipas nenit 40 te Ligjit Nr.7638 datë 19.11.1992 " Për shoqëritë tregëtare " , janë depozituar në Noteri Silvana Merko **3.300.000** lekë , vlera kjo me te cilen të bëhet zmadhimi i kapitalit themeltar të shoqërisë me kontribute ne para, konforme nenit 62 të Ligjit Nr.7638 datë 19.11.1992 " Për shoqëritë tregëtare "
3. 3- Përfundimisht nga vlera totale (Kontribut në natyrë plus ngutësimi për fitimet, në shumën prej **13.898.333** lekë , shuma prej **98.333** lekë , mbështetur në nenin 213 të Ligjit Nr. 7638 datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregëtare " , të kalojë si rezervë ligjore e shoqërisë, kurse me vlerën prej **13.800.000** lekë , vendosa të zmadhohet Kapitali themeltar i shoqërisë , i cili së bashku me Kapitalin themeltar të rregjistruar më pare për shumën **100.000** lekë, Kapitali themeltar i shoqërisë shkon në shumën **13.900.000** lekë, vlerë kjo e gjithë 100 % në pronësi të shoqërisë "MILO - 2000 " Shpk Permet .

Miratohet ndarja në pjesë e kapitalit themeltar dhe vlera e një pjese nuk mund të jetë më e vogël se 10.000 lekë . Gjithsejt vlera e pjesëve të Kapitalit themeltar të

shoqërisë shkon në masën 1390 pjesë, të cilat janë 100 % në pronësi të ortakut të vetëm themelues .

Kapitali i nënshkruar i shoqërisë , mund t'i rikthehet ortakut të vetëm ose ortakëve (në rast shtimi të tyre në shoqëri), vetëm me rastin e likuidimit të shoqërisë , ose në rastin e tërheqjes së kuotës dhe pjesës së tij , duke mbajtur parasysh zhvillimin dhe rezultatin e aktivitetit të shoqërisë ”.

4- Nga dega e finances se shoqerise te behen sitemimet perkatese ne kontabilitetin e shoqerise dhe te depozitohen aktet e ndryshimit te statutit per zmadhimin e kapitalit ne regjistrin tregetar.

5- Te pasqyrohen ndryshimet ne statutin dhe aktin e themelimit te shoqerise .
Te depozitohen vendimi ne regjistrin tregetar Tirane.

ORTAKU I VETËM I SHOQERISE

(Olsi MILLO)

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE
NOTERE SILVANA MERKO

NR. 642) Repertori

VERTETIM

Ne Tirane , sot me date 21/07/2005 , para meje noteres Silvana Merko, anetare e dhomes se noterise Tirane ,me seli ne blv“ Gjergj Fishta” m’u paraqit personalisht: Olsi Milo.,madhor, banues ne Permet, identifikuar sipas ligjit, i cili deklaroi se sa me siper eshte nenshkruar prej tij me vullnet te lire.

Une noterja si u binda per identitetin,vertetoj nenshkrimin per t'i dhene fuqi ligjore.



NOTERE
SILVANA MERKO



R A P O R T

PER VLERESIMIN E KONTRIBUTIT NE NATYRE TË SHOQËRISË

“ MILO-2000 “ SH.P.K. P E R M E T

ORTAKUT TE VETEM të Shoqërisë “ MILO-2000 “ SHPK

Zoteri i nderuar !

Në ekzekutim të misionit që më është besuar nga ana juaj , kam nderin t'ju paraqes Raportin tim që ka të bëjë me vlerësimin e kontributit në natyrë , e cila do të formojë kapitalin themeltar të nenshkruar per Shoqërinë suaj.
Për vlerësimin e kontributit në natyrë u mbështeta :

Në ligjin Nr. 7638 datë 19.11.1992 “ Për shoqëritë tregëtare “ dhe konkretisht në nenet 42 dhe 85 të tij, ku si Ekspert Kontabël i Autorizuar më jep të drejtën të ndërhyj në vlerësimine kontributeve në natyrë.

Në mbështetje të Ligjit më sipër , verifikova kontributet në natyrë dhe pasi i vlerësova , ato rezultojnë si më poshtë :

PASQYRA E GRUPIT TE A.Q.TUPEZUARA DERI 31.12.2004

Lekë

Nr	Emërtimi i grupit të AQT	Sipas Bilançit të fund vitit 2004
1	Plakueri	1.050.000
2	Mjete transporti	9.548.333
	S H U M A	10.598.333

Amortizimi i akumuluar nga përdorimi i tyre për vitet 2000 -2004 deri 31.12.2004 , është i regjistruar ne kontabilitet vetem per aktivet e regjistruara ne shumen **2.528.619 lekë**.

Për vlerësimin e kontributeve në natyrë procedurat janë përcaktuar :

1- Në Planin kontabël të përgjithshëm të Miratuar nga Këshilli i Ministrave me Vendimin Nr. 334 datë 09.07.1993.

2- Në Ligjin për Kontabilitetin Nr. 7661 datë 19.01.1993 dhe konkretisht në nenet 59 dhe 60 .

Për vlerësimin e kontributeve në natyrë gjeta dokumentacionin e nevojshëm si dokumentat e hipotekimit të ndertese,deklaratat doganore të importit ,kontarta shitje-blerje,fletë hyrjet dhe fletë daljet e rregullta, gjithë inventarizimin për vitin 2004 të mjeteve të transportit këto të kontabilizuara në Aktivitet e qendrueshme të trupëzuara në librat e llogarisë të shoqërisë.

Në natyrë kontributet përbëhen nga toka terrene dhe mjete transporti, sipas inventarit të veçantë dhe të përshkruar në sasi, lloje dhe me vlerat përkatëse për çdo lloj zëri të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara (dokumentacion qe ndodhet prane shoqerise "MILO-2000" SHPK

Pra sa përshkova më sipër të gjitha këto objekte në natyrë , të inventarizuara në emër dhe për llogari të shoqërisë janë Aktive të qëndrueshme të trupëzuara dhe formojnë Kontributet në natyrë të investuara nga shoqëria dhe që përbejnë edhe vlerë për kapitalin themeltar të shoqërisë " MILO-2000 " Sh.p.k. Permet . Për madhësinë se në çfare vlere do të bëhet ky zmadhim kapitali duhet të shprehet ortaku i vetëm i shoqërisë .

Ky Raport u plotësua në dy kopje të barabarta nga të cilat një kopje i jepet Ortakut të vetëm shoqërisë dhe tjetra mbahet nga Eksperti kontabël i autorizuar.

Permet, me 21/07/2005

EKSPERTI KONTABËL I AUTORIZUAR
Bashkim GJATA

